



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
Drejtoria e Procedurave dhe Vjeljes së Detyrimeve

Adresa: Rr. "Sami Frashri", Tirane

Tel 243920, 256547, Fax 274649

Nr 1661 Prot

Tirane, me/..../2006

U D H Ë Z I M

Nr. _3_ datë _09_. _02_. 2006

Për zbatimin praktik të përfitimit dhe operimit me rregjimin e magazinimit doganor.

Në zbatim të neneve 121 - 135 të Ligjit nr.8449 datë 27.01.1999 "Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë" dhe pikave 240 - 271 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.205, date 13.04.1999, lidhur me zbatimin praktik të Rregjimit të Magazinës Doganore, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave :

U D H Ë Z O N

Për përfitimin dhe operimet me rregjimin e magazinimit doganor do të veprohet si me poshtë:

1.Aplikimi për të përfituar rregjimin e magazinimit doganor

Aplikimi për rregjimin e magazinimit doganor bëhet pranë degës doganore mbikqyrëse dhe duhet të përmbajë:

- 1.1 Kërkesën tip sipas aneksit 1 (aneksi 26).
- 1.2 Çertifikatën e NIPT-it fotokopje të noterizuar.
- 1.3 Dokumentacionin ligjor të themelimit të shoqërisë.
- 1.4 Dëshmi penalteti, vërtetim së nuk ka ndjekje penale, të administratorit apo drejtorit të përgjithshëm, vërtetim së shoqëria nuk është në proces likuidimi.

- 1.5 Planimetri të ambienteve të planifikuara për rregjimin e magazinimit doganor të shoqëruara me foto për çdo plan si brënda ashtu edhe jashtë.
- 1.6 Aktin e kalibrimit të kontenierëve (depozita, sillosa, etj.) në rastet kur do të depozitohen lëngje apo materiale rifuxho.
- 1.7 Aktin e pronësisë së këtyre ambienteve ose kontratën e qiramarrjes (me një afat që përputhet minimalisht me planifikimin ekonomik të shoqërisë).
- 1.8 Një raport ekonomik minimalisht 2 vjeçar qe tregon nevojën ekonomike të shoqërisë për përdorimin e rregjimit të magazinimit doganor. (sipas modelit të aneksit 2)
- 1.9 Një opinion nga dega e tatimeve ku është e regjistruar shoqëria në lidhje me aktivitetin e saj ekonomik.
Dokumentacioni i mësipërm dorëzohet në degën doganore e cila do të mbikqyre këtë rregjim.

2. Procedura pregatitore

- 2.1 Kryetari i doganës shqyrton dokumentacionin e paraqitur në tërësi dhe veçanërisht raportin ekonomik dhe në se e gjen me vend (të plotë e të saktë) nxjerr urdhrin e vizitës në ambientet e planifikuara për magazinim doganor. (sipas aneksit nr 3)
- 2.2 Doganierët (2-3) e ngarkuar me këtë urdhër kryejnë vizitën në këto ambiente jo më vonë se 1 ditë nga dalja e urdhërit.
- 2.3 Vizita konsiston në verifikimin dhe plotësimin e të gjithë kërkesave që janë paraqitur në urdhër. Me mbarimin e vizitës aneksi 3 firmoset dhe i përcillet kryetarit të doganës.
- 2.4 Në se nga shqyrtimi i aneksit 3, nuk ka problematika që çenojnë funksionimin korrekt të rregjimit dhe mbikqyrjen e tij , vazhdon procedura me plotësimin e pjesës së mbetur nga aneksi 3 e cila i përket opinionit të kryetarit të degës së doganës, në të kundërt i kthehet përgjigje zyrtarisht për arsyet e ndërprerjes së procedurës së miratimit , mangësitë qe duhet të plotësohen, jo me vone se 1 jave nga paraqitja e kërkesës.
- 2.5 Jo me vone se 1 javë nga paraqitja e kërkesës dokumentacioni së bashku me aneksin 3 i përcillet departamentit teknik në DPD, dhe një kopje identike mbahet nga dega.

3. Shqyrtimi dhe miratimi

Brenda 3 ditësh nga paraqitja e dokumentacionit të plotë ngarkohet një specialist për verifikimin e dokumentacionit.

- 3.1 Verifikimi konsiston në:
 - 3.1.1 Shqyrtimin e gjithë dokumentacionit.
 - 3.1.2 Shqyrtimin e anekseve 2 dhe 3.
 - 3.1.3 Kërkesë informacioni shtesë brenda DPD për shoqërinë në fjalë.
 - 3.1.4 Vizitë shtesë në ambientet e planifikuara për magazinim doganor në se ka nevojë për saktësime apo riverifikime.
 - 3.1.5 Plotësim të pjesëve përkatëse në aneksin 3.

- 3.1.6 Procesi nuk duhet të zgjatë më shumë se 1 javë, brenda kësaj periudhe nëse ka mangësi njoftohet shoqëria për plotësim apo pamundësinë e aprovimit.
- 3.1.7 Për paraqitjen e garancisë bankare që garanton 100% të detyrimeve doganore të mallrave që magazinohen sidoqofte kjo garanci nuk mund të jetë më e vogël se 4.000.000 lek .
- 3.1.8 Përpilohet autorizimi dhe i paraqitet për miratim shkallës hierarkike vendimarrëse në Drejtorinë e Përgjithshme e cila brenda 1 javë duhet ta shqyrtojë dhe ta miratojë, nëse nuk gjendet me vend njoftohet zyrtarisht shoqëria për shkaqet e mos aprovimit të këtij rregjimi.
- 3.19 Pas aprovimit njoftohet shoqëria për të shlyer taksen vjetore të rregjimit të magazinimit doganor. Me shlyerjen e kësaj takse autorizimi bëhet i vlefshëm në sistem dhe i dërgohet degës apo degëve që do të operojnë me këtë rregjim.

4. Vlefshmëria e këtij rregjimi.

- 4.1 Autorizimi do të ketë një vlefshmëri prej 6 muajsh e cila do të shërbejë si periudhë prove dhe testi për justifikimin ekonomik të këtij rregjimi.
- 4.2 Para mbarimit të këtij afati dega e doganës mbikqyrëse dërgon në DPD një raport mbi vazhdueshmërinë e këtij rregjimi, raporti duhet të përpilohet sipas modelit të aneksit 4 dhe duhet të jetë i miratuar nga kryetari i degës doganore.
- 4.3 Në bazë të raportit përpilohet autorizimi definitiv i cili aprovohet brenda 1 javë, në të kundërt njoftohet shoqëria për humbjen e rregjimit me arsyet përkatëse.
- 4.4 Për çdo ndryshim në autorizim përveç garancisë doganore ndiqet e njëjta procedurë sikur të ishte autorizim i ri (me perjashtim të dokumentacionit të parashikuar në pikat 1- 9).

5. Detyrimet e administruesit të rregjimit të magazinimit doganor.

- 5.1 Plotësimi i regjistrit të magazinimit doganor standart të prodhuar nga DPD sipas aneksit 5 dhe 5/1. Mos plotësimi i këtij regjistri apo plotësimi me mangësi konsiderohet shkelje dhe trajtohet sipas penalteteve të parashikuara nga Kodi Doganor , regjistri elektronik nuk mund ta zëvendësojë plotësimin e regjistrit tip. Në rastet kur është autorizuar edhe depozitimi i mallrave shqiptare në të njëjtat ambiente detyrimisht duhet të jetë plotësuar libri i inventarit sipas aneksit 6 .
- 5.2 Dorëzimi zyrtar brenda çdo datë 5 të muajit pasardhës i gjendjes së stokut në degën e doganës mbikqyrëse.
- 5.3 Krijimi i kushteve të kontrollit të rregjimit (dokumentar e fizik) në çdo moment kur dega e doganës është e interesuar.

Moskrijimi i tyre do të konsiderohet refuzim i kontrollit doganor dhe do të penalizohet deri në revokim të autorizimit.

- 5.4 Në rastet kur shoqëria për arsye të ndryshme nuk mund të kryejë aktivitet duhet të njftojë dhe kërkojë pezullimin e rregjimit Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave. Ky pezullim aprovohet vetëm në rastet kur nga dega mbikqyrëse egziston konfirmimi se gjendja e stokut është 0 (zero) dhe nuk ka asnjë detyrim, në të kundërt do të konsiderohet si rregjim pa efekt ekonomik dhe do të revokohet.
- 5.5 Pagesa e tarifës vjetore të magazinimit doganor, brenda afatit.
- 5.6 Garanci të vlefshme të aprovuar nga DPD jo më pak se 4.000.000 lek, kërkesa për rinovim të garancisë nuk mund të bëhet më vonë se 10 dite para mbarimit të afatit të garancisë së vlefshme të autorizuar nga DPD.
- 5.7 Mos plotësimi i dy detyrimeve të fundit përbën një shkak të mjaftueshëm administrativ për revokim të autorizimit të magazinimit doganor.

6. Formalitetet e vendosjes së mallrave nën rregjimin e magazinës doganore:

- 5.1 Për të gjitha tipet e magazinave vendosja e mallrave nën rregjimin e magazinës doganore kushtëzohet nga paraqitja e mallrave në magazinë dhe depozitimi pranë zyrës doganore mbikqyrëse i dokumentit administrativ të vetëm (DAV) i cili plotësohet si më poshtë;

Kutia 1:

-Nëndarja e parë: **IM**

-Nëndarja e dytë:

- - **7** Vendosje në magazinim, përfshirë vendosjen e mallrave në ambiente të tjera nën kontrollin doganor.
- - **9** Furnizime bordi, Duty free shop

Kutia 37:

A – nendarja e majte:

Kodet që aplikohen në këtë nëndaje janë katër shifrore. Dy shifrat e para tregojnë rregjimin e kërkuar dhe bazohen në kodet e nëndarjes së dytë të kutisë 1.

- në rastin e importit:

- - **71** Rregjimi i magazinimit doganor për mallra jo-shqiptare
- - **72** Rregjimi i magazinimit doganor për mallra shqiptare
- - **95** Furnizime bordi
- - **96** Furnizime për Duty free shop

Dy shifrat që vijojnë janë vazhdimësi e dy të parave përmendur më lart dhe tregojnë rregjimin doganor të mëparshëm. Për këtë arsye nëndarja e majte e kutisë 37 do të ketë 4 shifra me kombinime të ndryshme, të cilat gjenden në sistemin Asycuda++.

B – Nënndarja e djathte:

Një prej kodeve të miratuara të procedurës së zgjeruar në sistemin Asycuda++.

Kutia 49: Shënohet numri i identifikimit të magazinës sipas atij të dhëne në autorizimin e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për miratimin e magazinës doganore. Ky numër përbehet nga germa korresponduese e tipit të magazinës dhe numri që individualizon çdo magazine brenda zyrës doganore mbikëqyrëse p.sh.;

- **A kodi i magazines**
- **C kodi i magazines**
- **E kodi i magazines.**

Autoritetet doganore të zyrës mbikëqyrëse nuk lejojnë hyrje mallrash në rregjim në rast se shumica e detyrimeve doganore nuk mbulohet nga garancia e pranuar .

6.2 Te Dhënat e Mallit. (Pergjegjesite e administruesit sipas nenit 124)

Administruesi i magazinës duhet të regjistrojë rregullisht në regjistrin të gjitha mallrat që hyjnë e dalin nga magazina. Regjistri përkatës duhet të mbahet në ambientet e magazinës. Regjistri i mallrave do t'i vihet në dispozicion administruesit të magazinës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave sipas modelit të përshkruar në Aneksin 5 dhe 5/1 të këtij Udhëzimi. Regjistrimi i mallrave në regjistrin e magazinimit doganor bëhet në momentin e vendosjes fizike të tyre në ambientet e përcaktuara të magazinës. Regjistrimi në regjister duhet të bëhet jo më vonë se lëshimi i deklaratës për mbylljen (përfundimin) e këtij rregjimi, me destinacionin përkatës.

6.3 Manipulimet e lejuara të mallrave nën rregjim.

Manipulimet e zakonshme:

Sistemim

Ajrim

Ndarje sipas llojit sasise cilësise etj

Grupim për plotësim të porosive.

Manipulime të autorizuara.

Amballazhim.

Riamballazhim në konfeksione të ndryshme tregtare.

Etiketim duke ruajtur parimet e cilësisë dhe origjinës.

Seleksionim.

6.4 Afati i qëndrimit të mallrave nën rregjim.

Ne baze të nenit 131 të Kodit Doganor mallrat mund të qëndrojnë në magazine jo me shume së 12 muaj nga data e magazinimit. Kërkesa për shtyrjen e këtij afati, së bashku me argumentimin ekonomik përkatës paraqitet pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave , i cili në rast se e shikon të arsyeshme mund ta shtyje afatin edhe për 12 muaj të tjerë. Megjithatë, kur rrethanat e jashtëzakonshme e kërkojnë, afati i qëndrimit të mallrave në magazine mund të vendosen brenda kufijve kohore me të shkurtër

7. Transaksionet tregtare brenda rregjimit të magazinimit doganor.

- 7.1 Rregjimi i magazinimit doganor lejon kryerjen e transaksioneve tregtare (shitje brenda rregjimit) duke presupozuar qe mallrat janë jo shqiptare dhe për tu bere të tilla duhet tu nënshtrohen rregullave doganore ose rieksporit apo destinacioneve të tjera doganore.
- 7.2 Te gjitha këto transaksione janë objekt i legjislacionit tatimor shqiptar dhe bëhen konform rregullave të tij.
- 7.3 Te gjitha transaksionet do të bëhen me fatura tatimore shitje të miratuara dhe në asnjë rast nuk mund të pranohen transaksione nen kosto.
- 7.4 Ne rastet e transaksioneve në magazinat e tipit C do të plotësohet aneksi nr 7 për mundësimin e veprimeve.

8. Mbyllja e rregjimit

Mbyllja e rregjimit konsiston në hedhjen në qarkullim të lire, rieksporimin apo dhënien e një destinacioni tjetër doganor.

Kutia nr 40

Ne ketë kuti shkruhet numri dhe data e dokumentit (DAV) të futjes të mallit në rregjim.

Kutia 37

Procedurat përkatëse qe do të plotësohen në kutinë 37 do të jene ato të sugjeruara nga sistemi automatik të administrimit të veprimeve doganore Asycuda++.

9. Revokimi, anulimi.

- 9.1 Vazhdimësia e autorizimit në fuqi do të varet nga përmbushja e kushteve të autorizimit në lidhje me kontrollin doganor, zhdoganimet, të dhënat e mallit dhe pagesën e shumës së shërbimi prej 200.000 Leke për çdo periudhe 12 mujore, për të mbuluar shpenzimet administrative të autoriteteve doganore, në

përputhje me piken 248.5 të Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor.

- 9.2 Ne rast se zyra doganore mbikëqyrëse konsideron se administruesi i magazinës ka dështuar të plotësojë kushtet e renditura me lart ose që nuk ekziston me një nevojë ekonomike për rregjimin, atëherë do të propozojë revokimin ose anulimin e autorizimit.
- 9.3 Drejtori i Përgjithshëm në baze të dhënave të paraqitura dhe argumentimit përkatës, pasi shqyrton rastin në fjale, mund të revokojë ose anulojë autorizimin.
- 9.4 Revokimi i autorizimit mund të bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm edhe për shkaqe të tjera të arsyetuara konform legjislacionit që parashikon shkelje të këtij rregjimi.

10. Dispozitat kalimtare

- 10.1 Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.
- 10.2 Udhëzimi 1 dt 06.06.2005 ç'fuqizohet.
- 10.3 Pas datës 15 mars 2006 të gjitha rregjimet e magazinimit doganor të aprovuara para daljes së këtij udhëzimi do të revokohen.
- 10.4 Ngarkohet Drejtoria e Procedurave dhe Vjeljes së Detyrimeve për mbikëqyrjen e zbatimit e funksionimit të këtij udhëzimi.

Përparim DERVISHI

DREJTOR I PERGJITHSHEM

**MODEL KERKESE PER AUTORIZIM PER ADMINISTRIMIN E NJE MAGAZINE
DOGANORE OSE PER PERDORIMIN E RREGJIMEVE NE NJE TIP MAGAZINE**

1. Emri ose emri i firmes dhe adresa¹:
2. Vendi i sakte qe synohet te perdoret si magazine doganore ose, kur kerkesa behet per nje magazine te tipit E, pershkrimi i ambjenteve per ruajtje te perdorura nga kerkuesi:
3. Tipi i magazines per te cilen behet kerkesa²:
4. Procedurat per³:
 - a) futjen e mallrave per rregjimet:.....
 - b) vendosjen ne qarkullim te lire te mallrave te futura per rregjime
 - c) ri eksportimi i mallrave te futura per rregjimet:
 - d) transferimi tek nje magazine doganore tjeter para perfundimit te procedures (ne rastet kur zbatohet).....
5. Percaktimi i nevojës ekonomike per magazinën doganore:
6. Përshkrimi i regjistrave të mbajtura ose që planifikohen dhe vendi ku ato mbahen ose do të mbahen:
7. Periudha mesatare e magazinimit⁴:
8. Lloji i mallrave për magazinim:
9. Format e zakonshme të parashikuara për ruajtjen e mallrave për të cilat kërkohet një autorizim i përgjithshëm:
10. Zhvendosjet e perkohshme të parashikuara për të cilat kërkohet një autorizim i përgjithshëm:
11. Operacionet e parashikuara në magazine në rregjimet për:
 - a) perpunimin pasiv:
 - b) perpunimin nën kontrollin doganor:
12. Magazinimi i mallrave shqiptare që nuk vendosen nën regjim:
13. Parashikimi për magazinimin e përbashkët i kategorive të ndryshme të mallrave⁵:
14. Zyrë mbikqyrese e sygjerruar:
15. Kërkesa për zbatimin e regjimit të përmendur në pikën 248 (8) dhe sygjerimi i zyrës doganore për vendosjen nën regjim:

.....
.....
16. Lista e dokumenteve shoqeruese bashkengjitur⁶:

.....
.....
.....

Data:

Firma:

SHENIME PER ANEKSIN 26

¹ Ne qofte se kerkesa behet ne leter me koke te kerkuesit dhe keto te dhena paraqiten ne te, nuk eshte e nevojshme te behet perseritja e tyre.

² Percaktoni, sipas preferences ku eshte e nevojshme, nje nga tipet e percaktuara ne pikën 241

³ Percaktoni ne menyren e pershtatshme :

- a) rregjimin normal te hyrjes,
- b) rregjimin normal te permbylljes.

⁴ Vetem per magazinat e tipit B (per magazinime afat shkurtra per te shkurtuar shpenzimet administrative te kontrolleve).

⁵ Percaktoni ne menyren e pershtatshme:

- a) mallrat industriale jo shqiptare,
- b) mallrat jo shqiptare me aksize,
- c) mallrat industriale shqiptare,
- d) mallrat shqiptare me aksize.

⁶ Per shembull planin, perskrimin e detajuar te vendit qe synohet per magazinimin e mallrave apo te regjistrave.

Aneksi 2

Raporti Ekonomik i Planifikuar

Nr	Artikujt e planifikuar per magazinim doganor	Vlera ne Euro per 2 Vite	Vlera ne Euro per 2 Vite e planifikuar per ri-eksport
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			

Shperndarja e importeve ne vlere per 2 vitet ne vazhdim (ne euro)

Muajt											
Viti 200_											
Viti 200_											

Shuma e detyrimeve doganore te pezulluara per dy vitet ne vazhdim (ne lek)

Muajt											
Viti 200_											
Viti 200_											

Koha mesatare e qendrimit nen regjimin e magazinimit doganor nga _____ dite deri _____

Shuma mesatare tremujore e planifikuar e likuiditeteve garkulluese qe zevendeson perdorimi i ketij rregjimi _____ leke

Aneksi 3

është e regjistruar shoqëria në lidhje me aktivitetin e saj ekonomik		
Vizite suplementare	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>

Te tjera për tu cilësuar

Shqyrtoi Dokumentacionin _____

Përpiloi autorizimin Po Jo Date _____

Aneksi 3

Kërkesën tip sipas aneksit 1	E sakte <input type="checkbox"/>	E pasakte <input type="checkbox"/>
Certifikatën e NIPT-it fotokopje të noterizuar	E sakte <input type="checkbox"/>	E pasakte <input type="checkbox"/>
Dokumentacionin ligjor të themelimit të shoqërisë.	E sakte <input type="checkbox"/>	E pasakte <input type="checkbox"/>
Dëshmi penaliteti, vërtetim se nuk ka ndjekje penale, të administratorit apo drejtorit të përgjithshëm, vërtetim se shoqëria nuk është në proces likuidimi	E sakte <input type="checkbox"/>	E pasakte <input type="checkbox"/>
Planimetri të ambienteve të planifikuara për regjimin e magazinimit doganor të shoqëruara me foto për çdo plan si brenda ashtu edhe jashtë	E sakte <input type="checkbox"/>	E pasakte <input type="checkbox"/>
Aktin e kalibrimit të kontenierëve (depozita, sillosa, etj.) në rastet kur do të depozitohen lëngje apo materiale rifuxho	E sakte <input type="checkbox"/>	E pasakte <input type="checkbox"/>
Aktin e pronësisë së këtyre ambienteve ose kontratën e qiramarrjes (me një afat që përputhet minimalisht me planifikimin ekonomik të shoqërisë	E sakte <input type="checkbox"/>	E pasakte <input type="checkbox"/>
Një raport ekonomik minimalisht 2 vjeçar qe tregon nevojën ekonomike të shoqërisë për përdorimin e regjimit të magazinimit doganor. (sipas modelit të aneksit 2)	E sakte <input type="checkbox"/>	E pasakte <input type="checkbox"/>
Një opinion nga dega e tatimeve ku	E sakte <input type="checkbox"/>	E pasakte <input type="checkbox"/>

Aneksi 3

Ambjente pune per doganen

	Te pershtatshme	Te pa pershtatshme
Mundesite e kontrollit dhe mbikqyrjes se sakte	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Pershtatshmeria e ambientit per manipulimet e kerkuara	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
Pershtatshmeria e ambientit per te ruajtur mall jo shqiptar dhe shqiptar	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
Egziston mundesia per regjime te tjera vezulluese ekonomike brenda ambienteve te magazinimit	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>
Koha mesatare per distancen nga dega doganore deri ne keto ambjente	_____min	

Te tjera per tu cilesuar

Doganieret

1.	2.	3.
1.	2.	3.

Opinionimi i Kryetarit te Degës Doganore Jam dakord Nuk jam dakort

Kryetari i Deges se Doganes _____ Dt _____ Firma vula _____

Specialisti i ngarkuar për shqyrtim ne DDP _____

Aneksi 3

Dega e Doganës _____

Nr _____ prot

Date ___/___/___

Ngarkohen për të vizituar ambientet e planifikuara për magazinim doganor nga

Shoqëria _____ NIPT _____

1. _____
2. _____
3. _____

Ngarkoi me kete detyre

Kryetar i Deges se Doganes

Te dhena te pergjithshme

Adresa e ambienteve _____

Nr telefoni _____ nr fax _____ email _____

Administratori _____ Firma _____

Person i autorizuar _____ Firma _____

Konstatimi fizik

Ambiente te hapura _____ m2

Te përshatshme

Te pa përshatshme

Ambiente te mbyllura _____ m2

Te përshatshme

Te pa përshatshme

Mundesite e plumbasjes

Po

Jo

Per tu përdorur ne rast
riverifikimi

Aneksi 4

Dega e Doganes _____

Nr _____ prot

Date ___/___/_____

Propozim per kalim ne definitiv te autorizimit te magazinimit doganor

nr _____ dt _____

ne favor te shoqerise _____ NIPT _____

(Perskrim i shkurter i regjimit)

(realizimi i faktorit ekonomik)

Propozoj te kaloje ne regjim definitiv

Kryetari i Deges se Doganes

Aneksi 4

Dega e Doganes _____

Nr _____ prot

Date ___/___/_____

Propozim per kalim ne definitiv te autorizimit te magazinimit doganor

nr _____ dt _____

ne favor te shoqerise _____NIPT_____

(Pershkrim i shkurter i regjimit)

(realizimi i faktorit ekonomik)

Propozoj te kaloje ne regjim definitiv

Kryetari i Deges se Doganes

Aneksi 7**KERKESE PER SHITESH NE LIDHJET E KOMPANIVE PER
AUTORIZIMIN E MAGAZINIMIT DOGANOR**

Numer	Date	Kodi
-------	------	------

Emri i kompanise se re	
NIPT	
Afati kohor i operacioneve deri me	
Numri i operacioneve	
Adrinistratori i magazines doganore	Vula

Dega e Doganes	
Nr _____ Prot	Date
Doganieri Mbikqyres	Vula

Sektori i Procedurave	
Specialisti	Firma
Data e shiteses	